



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOSOVËS ME RASTIN E
NJËVJETORIT TË MIRATIMIT TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 8 PRILL 2009

SA SVEÇANE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA POVODOM GODIŠNJICE
DONOŠENJA USTAVA REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 8. APRILA
2009.GODINE

PRILL – APRIL
2009

TRANSKRIPT
I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOSOVËS ME RASTIN E
NJËVJETORIT TË MIRATIMIT TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 8 PRILL 2009

E mërkurë, 8 prill 2009, ora 10:00

Drejttoi seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë,
I nderuari President,
I nderuar Kryeministër,
Ministra,
Përfaqësues diplomatikë,
Të nderuar qytetarë që na përcillni përmes Radio-televizionit të Kosovës,

Sot, kam nderin të hap punimet e seancës solemne të Kuvendit, me rastin e njëvjetorit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

(Intonimi i himnit)

Kam nderin të hap punimet e seancës solemne të Kuvendit, në shënimin e njëvjetorit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në historinë e re të Kosovës, 9 prilli i vitit 2008 shënon ditën e miratimit të Kushtetutës, të aktit më të lartë juridik dhe politik të shtetit tonë.

Kosova ka traditë kushtetuese që nga viti 1974, por para një viti, pa u bërë dy muaj nga shpallja e Pavarësisë, për herë të parë ratifikoi Kushtetutën e shtetit të pavarur, sovran e demokratik.

Rëndësia historike e Kushtetutës së re qëndron në sanksionimin juridik që i bën Pavarësisë, por ajo përcakton njëkohësisht orientimin demokratik, evropian të shtetit tonë, duke ligjësuar standardet moderne shtetërore, si barazia qytetare, të drejtat e liritë themelore të njeriut, të drejtat e komuniteteve pakicë, ndarja e pushteteve, qeverisja demokratike, sundimi i së drejtës, ekonomia e tregut, siguria e të tjera. Ajo përbën vullnetin e popullit tonë për pavarësi, liri e demokraci, por edhe bazën e sistemit politik, ekonomik e shoqëror të Kosovës.

Kosova i ka vënë themelet demokracisë kushtetuese, duke përcaktuar qartë dhe prerë kompetencat e përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, në njërën anë, dhe të drejtat e qytetarëve, në anën tjetër. Kushtetuta përbën ligjin suprem dhe aktin e kontratës midis qytetarëve dhe institucioneve shtetërore.

Demokracia mund të ndërtohet vetëm me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. Institucionet e Kosovës angazhohen fuqishëm dhe çdo ditë për të krijuar kushtet e pjesëmarrjes demokratike të të gjithë qytetarëve të integruar në ngritjen e jetës sonë të re dhe të mirëqenies së përgjithshme në ndërtimin e shtetit tonë të përbashkët. Pushteti lokal dhe politika e decentralizimit që po zbatojmë, do të mundësojnë këtë pjesëmarrje në përmasa të gjera dhe sa më gjithëpërfshirëse. Kushtetuta është akti ynë garantues i të drejtave të secilit dhe për të gjithë njësoj. Kosova nuk mund të ketë disa kushtetuta e as zona të juridiksionit të ndryshëm, sepse nuk do të mund të funksiononte sistemi unik politik, ekonomik e juridik i saj, sepse ashtu do të dëmtoheshin në radhë të parë interesat e vetë qytetarëve.

Miratimi i Kushtetutës ishte akt madhor dhe shumë i rëndësishëm, por vetëm zbatimi i saj konsekuent dhe i plotë i jep asaj vlerën e vërtetë. Sot, një vit pas miratimit të Kushtetutës, vazhdojmë ta kemi sfidë zbatimin e saj në të gjitha nenet dhe në të gjithë territorin e Republikës. Në këtë përvjetor të parë të Kushtetutës, u bëj thirrje institucioneve përgjegjëse dhe të gjithë qytetarëve, pa asnjë dallim, të respektojnë e të zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, sepse kjo është mënyra e vetme për ndërtimin e shoqërisë sonë demokratike, mënyra e vetme për ndërtimin e shtetit tonë modern e të përbashkët, mënyra e vetme e ngritjes së mirëqenies së përgjithshme dhe e integritetit tonë në familjen e madhe të popujve evropianë. Zbatimi i Kushtetutës siguron funksionimin e sistemit shtetëror të Kosovës, siguron sundimin e ligjit dhe vendosjen e rendit demokratik në Kosovë.

Hartimi dhe miratimi i Kushtetutës, sikur edhe shpallja e Pavarësisë, ka qenë në partneritet të Kosovës me Bashkësinë Ndërkombëtare dhe e kontraktuar midis tyre. Kjo kontratë përmban kompromisin e Kosovës në emër të ardhmes dhe për hir të paqes e të stabilitetit. Ky fakt na jep lirinë dhe të drejtën që nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe misionet e saj në Kosovë të kërkojmë angazhimin maksimal për garantimin e sovranitetit e të integritetit territorial të Kosovës dhe zbatimin e Kushtetutës në çdo pjesë të saj.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejon të them se pas shpalljes së Pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës, Republika e Kosovës, institucionet dhe qytetarët e saj, kanë arritur rezultate të shënuara e evidente në të gjitha fushat. Nga dita në ditë janë ndërtuar dhe konsoliduar institucionet e Pavarësisë, është ngritur niveli i jetesës së qytetarëve, po ndërtohet mirëbesimi ndëretnik, kurse në plan ndërkombëtar është rritur prestigji i vendit tonë e simpatia për të, si demokraci e re dhe e suksesshme, si shtet i qytetarëve të tij të barabartë. Në vigjilje të këtij përvjetori, Kosova shënoi njohjen e saj ndërkombëtare të 57-të me radhë.

Pas miratimit të Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës ka proceduar një numër rekord prej më shumë se njëqind ligjesh, me të cilat është mundësuar funksionimi i organeve të shtetit të pavarur dhe janë garantuar të drejtat e standardeve më të larta që ka njohur historia e shoqërisë njerëzore.

Këto ditë jemi në proces të formimit të Gjykatës Kushtetuese, si organ suprem i mbrojtjes dhe i interpretimit të Kushtetutës.
Ju faleminderit shumë!

(Duartrokitje)

I nderuar President Sejdiu, foltorja është e juaja!

PRESIDENTI I KOSOVËS, FATMIR SEJDIU:

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës, zoti Jakup Krasniqi,
Anëtarë të Kryesisë,
I nderuari Kryeministër Thaçi dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare,
Ambasadorë,
Zoti Feith, Kermabo dhe të gjithë të tjerët,
Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Dje, pas dreke, derisa po i hidhja shikimin e fundit këtij teksti që do ta lexoj përpara jush, mora konfirmimin zyrtar se Gambia njihte Republikën e Kosovës. Mbase, duket e pazakontë që një tekst kushtuar një kremteje të tillë, si Dita e Kushtetutës, po e nis kështu, por kjo njohje e shtetit tonë, ashtu si edhe 56 të tjerat para saj, ashtu si edhe shumë njohje që do të vijnë më pastaj, është dëshmi e pakundërshtueshme se vendi ynë, Republika e pavarur dhe sovranë e Kosovës ka arritur që gjatë këtij viti të shtetësisë së saj të dëshmohet si vend stabil e paqësor, si vend i sundimit të ligjit dhe i vlerave qytetare, si vend që nxit dhe kultivon frymën e fqinjësisë së mirë dhe të miqësisë me të gjitha vendet e botës demokratike.

Të dashur deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Një vit më parë, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Kushtetutën e Republikës. Sot, në këtë takim solemn të shënimit të Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kam kënaqësinë që t'ju shpreh sërish mirënjohjen time të gjithë deputetëve, të gjithë përfaqësuesve të zgjedhur të popullit, të cilët me votën e tyre e shndërruan këtë dokument në aktin më të lartë juridik e zyrtar të shtetit tonë të ri.

Në aspektin e rendit juridik, dita e miratimit të Kushtetutës së Republikës dhe dita e hyrjes së saj në fuqi, më 15 qershor, paraqesin dy datat më të rëndësishme për vendin tonë, duke pasur parasysh atë që është e vlerës së veçantë historike, shpalljen e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Sot, jo më shumë se një vit pas bërjes së Kushtetutës, Republika e Kosovës në të gjitha nivelet e funksionimit institucional, në legjislativ, në ekzekutiv dhe në gjyqësor, mbështetet mbi këtë akt fundamental të ligjshmërisë, të rregullit e të rendit juridik, politik dhe shoqëror.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është pikënisja dhe pikëmbështetja jonë, është dokumenti themelor për gjithë korpusin legjislativ të vendit.

Të dashur deputetë të Kuvendit të Republikës,

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është në harmoni të plotë dhe në përputhje me korpusin e standardeve më të larta ndërkombëtare të legjislacionit, para së gjithash me standardet legjislative evropiane. Ajo është baza e funksionimit të institucioneve të Kosovës, por edhe e Misionit ndërkombëtar që e kemi ftuar vetë për të këshilluar në fushën e sundimit të ligjit dhe të sigurisë. Pra, krahas me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, EULEX-i do t'i referohet në veprimet e veta edhe Planit të Përbashkët të Veprimit, i cili, po ashtu, mbështetet në Propozimin gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari.

Meqenëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës është themeli i funksionimit të institucioneve të vendit, të Parlamentit, të Presidencës dhe të Qeverisë, të organeve të pushtetit lokal, duhet të jenë po kështu një shembull i punës që buron dhe bazohet në Kushtetutë, puna e të gjitha këtyre institucioneve. Po e ritheksoj, vlera e saj si akti më i lartë juridik jetësohet me veprimet tona, me mënyrën se si dhe sa e respektojmë këtë dokument të lartë të vendit.

Siç e dimë tani, si President i vendit, unë kam bashkëpunim tepër të ngushtë dhe të përditshëm me këtë institucion të çmueshëm, me Kuvendin e Republikës. Kjo është një dëshmi e funksionimit të shtetit tonë dhe e bashkërendimit ndërinstitucional, gjithnjë duke i ruajtur përgjegjësitë dhe kompetencat e secilit institucion përkatës dhe në relacionet reciproke.

Njëkohësisht, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, janë krijuar dhe po fuqizohen dita-ditës shtyllat e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë së vendit tonë, Forca e Sigurisë së Kosovës, Agjencia e Inteligjencës së Kosovës dhe Këshilli Kombëtar i Sigurisë. Gjithashtu, janë hapur dhjetë misione diplomatike në botë, si dhe janë dekretuar tetë misione të reja diplomatike dhe nëntë misione konsullore.

Kështu, hap pas hapi dhe me kujdes të përhershëm, është rrumbullakuar qarku i institucioneve më të rëndësishme për funksionimin e shtetit tonë, që shpejt do të përmbyllet me krijimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës.

Për ta përmbyllur, po e ripërsëris atë që theksoja më 15 qershor të vitit 2008, ditën kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës po hynte në fuqi: Kushtetuta do të jetë shtylla kurrizore e organizimit tonë shtetëror. Kushtetuta jonë ngërthen zgjidhje moderne kushtetuese që vijnë nga trashëgimia demokratike, por edhe zgjidhje të veçanta për rrethanat dhe specifikat e Kosovës, si shoqëri shumetnike, me një shumicë dërmuese shqiptare dhe me komunitetet pakicë, të cilave u jepen garanci të fuqishme për të drejtat dhe privilegjet, të cilat janë shenjtëruar në Kushtetutë, pasi ishin pranuar si dispozita të Propozimit të Presidentit Ahtisari.

Këto janë garancionet tona. Këto janë orientimet tona dhe Kosova, natyrisht se do të ecë në zhvillimet e reja, në proceset e rëndësishme drejt integriteteve euroatlantike dhe në një miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet e Bashkimit Evropian dhe me vendet e botës demokratike.

Urime Dita e Kushtetutës!
Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit President! Tani ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, për një fjalë rasti.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar President i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Të nderuar përfaqësues diplomatikë në Kosovë,
Të nderuar ambasadorë,

Këtij Kuvendi, i dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike të nëntorit të vitit 2007, i takoi nderi dhe përgjegjësia për të marrë vendime të mëdha historike për vendin tonë. Këto janë vendime që ndajnë epokat e historisë sonë më të re.

Më 17 shkurt të vitit 2008, ne përbushëm aspiratën njëshekullore të popullit tonë për liri, pavarësi dhe rend demokratik. Shpallëm Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

Mes entuziazmit qytetar, përgjegjësisë shtetërore institucionale dhe mbështetjes së fuqishme ndërkombëtare, ne filluam procesin e fuqishëm të shtetndërtimit.

Filloi historia e re e Kosovës. Me historinë e re të vendit tonë ndihet krenar çdo shtetas i Kosovës. Brenda një viti ne bëmë punë të përbashkët të jashtëzakonshme në shtetndërtimin e Kosovës, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm.

Ndërtuam konsensusin politik dhe qytetar për të sotmen dhe të ardhmen tonë. Ndërtuam unitetin funksional, institucional, por edhe qytetar.

Natyrisht, kanë mbetur edhe shumë punë të tjera për t'u bërë. Por, vullneti, energjia dhe përkushtimi nuk na mungojnë. Përgjegjësia është rritur.

Shteti i Kosovës ka ndërtuar politika të qarta zhvillimore, të brendshme dhe të jashtme, që po japin fryte çdo ditë.

Shteti i Kosovës është njohur brenda vitit të parë të pavarësisë nga 57 shtete. Procesi i njohjes po vazhdon në mënyrë të pandalshme.

Së shpejti, Kosova do të anëtarësohet edhe Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Brenda vitit të parë të pavarësisë, Kosova ka shënuar rritje ekonomike mbi 5.5%.

Edhe në këtë kohë të krizës ekonomike globale financiare, po punojmë fuqishëm të gjithë që të vazhdojmë bashkërisht me trendët pozitivë të zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim nuk ka asnjë hezitim.

Zonja dhe Zotërinj,

Në krejt këtë proces historik, një ndër hapat e parë ishte miratimi i Kushtetutës së Republikës sonë. Kushtetuta e parë e vullnetit sovran të popullit të Kosovës.

Ne e miratuam aktin më të lartë juridik të shtetit tone të ri, Kushtetutën e standardeve më të avancuara demokratike, dokumentin themelor që garanton lirinë tonë të fituar me aq mund e sakrificë, sovranitetin e Republikës së Kosovës, që buron nga populli dhe ushtrohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike prej tij.

Ky sovranitet dhe integriteti territorial i Republikës sonë është i pacenueshëm dhe i njohur ndërkombëtarisht.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është dokumenti që shpreh në mënyrën më të mirë përkatësinë e vendit tonë në familjen e shteteve të lira dhe demokratike, identitetin shtetëror të Republikës së Kosovës, të bazuar mbi vlerat liberale perëndimore, sundimin e ligjit, barazinë e të gjithë qytetarëve para tij, pavarësisht dallimeve etnike apo religjioze, liritë themelore të njeriut, respektimin në shkallën më të lartë të të drejtave të minoriteteve, shoqërinë multietnike.

Një vit të rrugëtimit të shtetit tonë kishim edhe shumë sfida e ballafaqime, por edhe sukseset ishin të mëdha.

Do të vazhdojmë të punojmë bashkërisht, pa dallime për shtetin tonë të ri, për zhvillimin edhe më të hovshëm ekonomik dhe mirëqenie më të lartë sociale të qytetarëve tanë.

Të nderuar deputetë,

Le të punojmë bashkërisht në rrugën tonë, në vizionin tonë me besimin e popullit tone për integrimin e vendit tonë në strukturat e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, në bashkësinë e popujve të lirë.

Dëshiroj edhe njëherë, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në këtë ditë historike të vendit tonë të shpreh mirënjohjet dhe falënderimet më të mëdha për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e Bashkimit Evropian dhe të NATO-s për mbështetjen dhe njohjen e Kosovës. Për Kosovën do të ketë vetëm suksese. Urime!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Të nderuar deputetë,

Mysafirë,

Zonja dhe zotërinj,

Mbyllim seancën e sotme solemne dhe ju ftoj në një koktej rasti në hollin e Kuvendit.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve